



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të
Nr. 22/08
Prishtinë, më 11.09.2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Safete Hadergjonaj, Besa Gaxherri, Myrvete Pantina, Xhevdet Neziraj, Shkumbin Demaliaj dhe Hajdin Abazi.

Anëtarët jo të pranishëm: Armend Zemaj, Müfera Şinik dhe Behxhet Pacolli.

Nga shërbimi i sekretarisë së Kuvendit: Natasa Prica-Tisma, administratore e komisionit, Arta Hajra, zyrtare ligjore, Vilson Ukaj, zyrtar ligjor dhe Dashurie Canolli, nëpunëse administrative.

Gjithashtu të pranishëm ishin: përfaqësues nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) z. Hashim Rexhepi, Guvernator i BQK-së, z. Gani Gerguri, zv. Guvernator i BQK-së dhe znj. Shkëndije Himaj, zyrtare e lartë për mbikëqyrje financiare në BQK, z. Sakip Imeri përfaqësues i Administratës Tatimore të Kosovës, monitorues nga ZKM, USAID, MEF, OSCE, KDI, NDI, ZPK.

Kryesues: Gani Koci, kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës për vitin 2007**
Të ftuar:
Përfaqësuesit nga Autoritetit Qendror Bankar i Kosovës;

3. Shqyrtimi i Projektligjit L-090/1 për partneritet publiko-privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat me Kërkesën nr. 3192 e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për noterinë me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente.
6. Shqyrtimi i Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet tjera me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për Kualifikimet Kombëtare me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente;
8. Shqyrtimi i Projektligjit të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;
9. Shqyrtimi i Projektligjit për Organizmat e Modifikuar Gjenetikusht me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari hapi mbledhjen duke ftuar të pranishmit të deklarohen lidhur me propozimin për rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua me propozimin e anëtarëve që pika e 4 e rendit të ditës, pjesa e dytë që ka të bëjë me Kërkesën nr. 3192 e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave, të shqyrtohet si pikë e veçantë e rendit të ditës, përkatësisht si pikë e re 10 e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës për vitin 2007

Kryetari njoftoi anëtarët e komisionit se kishte propozuar për rend dite shqyrtimin e Raportit të Autoriteti Qendror Bankar të Kosovës (AQBK) për vitin 2007 dhe kishte ftuar përfaqësuesit e këtij autoriteti, më shumë për tu njoftuar me raportin dhe aktivitetet e Autoritet Qendror Bankar të Kosovës, tani me Kushtetutë e emëruar si Bankë Qendrore e Kosovës. Kjo për faktin se raporti në fjalë veç është përgatitur dhe dorëzuar për miratim të PSSP-ja para datës 15 qershor 2008, periudhë kjo kur AQBK sipas ligjit i përgjigjej PSSP-së. Ky raport është i miratuar nga PSSP prandaj duke falënderuar përfaqësuesit e Bankës Qendrore të Kosovës që të njëjtin e kanë përcjellë edhe në Kuvend, kryetari vlerësoi se nuk duhet të lëshohen në detaje dhe të debatojnë lidhur me raportin, por vetëm të njoftohen me të dhe me aktivitetet dhe rolin e ri të BQK-së.

z. Hashim Rexhepi Guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës, njoftoi anëtarët e komisionit, se në marrëveshje me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, raporti i Autoriteti Qendror Bankar të Kosovës për vitin 2007 u është shpërndarë deputetëve në formatin e shtypur. Ky raport është raport gjithëpërfshirës i punës dhe aktiviteteve të AQBK-së, i ndarë në gjashtë kapituj, si : kapitulli I i përmbledhjes ekzekutive, kapitulli II mjedisi i jashtëm ekonomik, kapitulli III ekonomia e Kosovës, kapitulli IV mbikëqyrja financiare, kapitulli V shërbimet e siguruara për

autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun dhe kapitulli VI zhvillimet e brendshme të BQK-së. Kurse, si shtojcë e veçantë e raportit, është bashkangjitur raporti komplet i Auditorit Gjeneral të Kosovës për Bankën Qendrore të Kosovës për vitin 2007.

z. Rexhepi bëri të ditur se kishte përgatitur një ekspozë lidhur me prezantimin e raportit para deputetëve, dhe të njëjtën do tua përcillte në formë të shkruar, në mënyrë që të mos lëshohet në detaje të raportit, pasi që ky takim kishte më shumë karakter informues, sesa debutues.

Informimin për anëtarët e komisionit lidhur me Raportin e AQBK për vitin 2007, z. Rexhepi e përmbledhi në disa elemente kyçe, si:

- Ekonomia botërore është duke u zhvilluar me një trend të ngecjes në zhvillimin ekonomik dhe rritje të inflacionit. Kjo situatë ka pasur ndikim edhe në Kosovë, me rritje të çmimeve, të cilat ishin stabile për një kohë.
- Në Kosovë rritja ekonomike është në 3.5 %. Kjo rritje ka rezultuar nga sektori privat, dhe atë nga investimet në këtë sektor, e që në një masë të madhe janë mbështetur nga kreditë në sektorin bankar. Megjithëkëtë, problem kyç për zhvillimin ekonomik të Kosovës, është shkalla e lartë e papunësisë, e cila sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar vlerësohet në 33 %.
- Kosova mbetet e përcjellë me një deficit të lartë në tregtinë e jashtme, ku llogaritet vlera prej 1.4 miliardë euro deficit nga importi.
- Inflacioni në Kosovë gjatë vitit 2007 ka qenë 4.4%, që vlerësohet shumë më i lartë se ai i vitit të kaluar. Një ngritje e tillë e shkallës së inflacionit i atribuohet kryesisht rritjes globale të çmimeve të naftës, që në të njëjtën kohë ka ndikuar në ngritjen e çmimeve tjera, e në veçanti në çmimet e ushqimit.
- Sektori më i suksesshëm gjatë vitit 2007 është treguar sektori financiar, me një numër transferesh në sistemin e pagesave prej 1.3 milion transfere. Ky numër është barazi me 2.5 miliardë euro të transferuara, që shënon një rritje prej 33 % krahasuar me vitin e kaluar.
- Rritje ka shënuar edhe sektori bankar, i cili në vazhdimësi po zgjerohet. Në vitin 2007, bankat e jashtme kanë paraqitur shtatë nga nëntë bankat komerciale në Kosovë, ndërsa janë llogaritur për 90.9% të tërësisë së mjeteve të sektorit bankar. Kreditë bankare gjithashtu shënojnë rritje prej 40%, përderisa ekonomitë familjare marrin pjesë në kreditë bankare me 22 %.
- Sektori mikrofinanciar në Kosovë ka shënuar një ecuri të mirë në këtë periudhë. Mirëpo synimi i Bankës Qendrore të Kosovës është që statusi institucioneve mikrofinanciare, që deri më tani janë njohur si organizata joqeveritare, të shndërrohet në organizata buxhetore biznesore, të cilat do të paguanin tatimet si të gjitha bizneset tjera dhe me këtë do të sjellin përfitime në buxhetin e republikës.

Sipas z. Rexhepi, sfida më e rëndësishme është anëtarësimi i Bankës Qendrore të Kosovës në Sistemin Ndërkombëtar të Pagesave, mirëpo ky autoritet është në procesin e negociatave për anëtarësim dhe gjithashtu mbanë marrëdhënie të mira me Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, USAID etj.

z. Rexhepi vlerësoi se Banka Qendrore e Kosovës është funksionale, operon e pavarur, pavarësi të cilën e ka të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Pas prezantimit të z. Hashim Rexhepi, Guvernator i BQK-së, anëtarët e komisionit të gjithë vlerësuan se raporti i parashtruar është një model shumë i mirë i raportimit, më i miri i dorëzuar deri më tani nga të gjitha institucionet të cilat i raportojnë Kuvendit të Kosovës për punën e tyre. Sipas anëtarëve të komisionit, ky raport është gjithëpërfshirës, i strukturuar dhe burim shumë i mirë i të dhënave, sidomos atyre statistikore, duke pasur parasysh mungesën e statistikave të sakta dhe reale në Kosovë.

Përveç përgëzimeve për hartimin e një raporti të mirë dhe një pasqyrim të plotë të punës së Bankës Qendrore të Kosovës për periudhën një vjeçare, anëtarët e komisionit ishin të interesuar që të shfrytëzojnë praninë e Guvernatorit të BQK-së për ti parashtruar disa pyetje për çështje të veçanta, e ndër to ishin:

Znj. Myrvete Pantina ishte e interesuar të dije se, duke pasur parasysh që normat e interesit për kredi janë shumë të pafavorshme në Kosovë, si rrjedhë e ofertave dhe kërkesave në tregun financiar dhe rrezikshmërisë së kapitalit të konsideruar të lartë deri tani në Kosovë, por nga ana tjetër duke u bazuar në fatin që Kosova ka përqindjen më të ultë në rajon sa i përket kredive të këqija, a ka mundësi që Banka Qendrore e Kosovës ti shfrytëzojë këto argumente për të zbritur interesin në kreditë bankare.

z. Haki Shatri duke vlerësuar Portofolin e kredive si më të mirë në krahasim me rajonin, ishte i interesuar të dijë se si qëndron çështja lidhur me plasmanët aktualë, që tregojnë aktivitetin e bankave afariste. Gjithashtu, z. Shatri vlerësoi të rëndësishme nëse Guvernatori do të paraqiste ndonjë koment lidhur me punën e Trustit Pensional të Kosovës.

z. Xhevdet Neziraj, parashtrroi pyetjen lidhur me sigurinë e qytetarëve të Kosovës të ruajnë paratë e tyre në banka, duke shtuar se a ka vepruar me kohë apo me vonësë Banka Qendrore e Kosovës në rastin e falimentimit të Bankës Kreditore dhe a i është bërë pagesa qytetarëve për mjetet e tyre të depozituara në këtë bankë.

z. Hajdin Abazi, ishte i interesuar rreth çështjes së Kartonit të Gjellbër, sigurimi i automjeteve gjatë udhëtimit jashtë vendit. Duke ditur faktin se mbi gjysmë milion qytetarë të Kosovës, të cilët jetojnë jashtë saj, gjatë vizitave që ata i bëjnë Kosovës, hasin në probleme lidhur me sigurimin e Kartonit të Gjellbër, meqë sigurimet të cilat njihen në shtetet evropiane nuk njihen në Kosovë, për këtë duhet nxjerrë sigurim i posaçëm për të pasur mundësi të vozitjes brenda territorit të Kosovës. Z. Abazi u shpreh i interesuar të dije se si qëndron Kosova lidhur me anëtarësimin e saj në shoqëritë ndërkombëtare të sigurimeve.

Znj. Safete Hadergjonaj u shpreh e interesuar që nga Guvernatori i BQK-së të ofrohej një informatë e shkurtër lidhur me aktivitet e BQK-pas pavarësisë së vendit. Si qëndron Banka Qendrore e Kosovës në procesin e negociatave për anëtarësim në institucionet ndërkombëtare financiare, në periudhën pas shpalljes së Pavarësisë. Gjithashtu, znj. Hadergjonaj parashtrroi pyetjen lidhur me kontrollin të cilin BQK e ushtron ndaj institucioneve mikrofinanciare, meqë 7 % e kredive kalojnë përmes këtyre institucioneve.

znj. Hadergjonaj kërkoi edhe një mendim nga Guvernatori lidhur me mundësinë dhe mënyrën e menaxhimit të mjeteve të Trustit Pensional të Kosovës, brenda Kosovës.

z. Shkumbin Demaliaj pyeti lidhur me vështirësitë që Banka Qendrore e Kosovës hasë kur kihet parasysh fakti që Kosova nuk ka valutë monetare të vetën, nuk prodhon, por e shfrytëzon si valutë të veten valutën Euro dhe e tërë ekonomia e Kosovës varet nga importi.

Znj. Besa Gaxherri ishte e interesuar të dijë se sa është e gatshme Banka Qendrore e Kosovës të sigurojë qytetarët e Kosovës se fondet e ndryshme të Kosovës që janë vendosur jashtë saj, të kthehen dhe investohen në Kosovë. Ajo vlerësoi se paratë në Trustin Pensional të Kosovës, janë para të qytetarëve dhe është obligim i Kuvendit dhe institucioneve përkatëse që të kontrollojnë këto para dhe ti shfrytëzojnë në mënyrën më të mirë të mundshme për çdo qytetar të vendit.

Z. Hashim Rexhepi, në formë përmbledhëse, u përgjigj në pyetjet dhe interesimet e shtruar nga anëtarët e komisionit, si:

- Sa i përket interesit të kredive, në aspektin ligjor, Banka Qendrore e Kosovës nuk ka të drejtë të ndërhyjë në caktimin e normave të kamatave. Është fakt që kamatat në Kosovë janë të larta, mirëpo kjo varet nga kostoja operative, trajnimi i stafit dhe risku me të cilin ballafaqohen bankat. Megjithatë, është një trend i rënies së lehtë të interesit të kredive, por kjo gjithsesi që varet nga disa faktorë si: shkalla e rejtingut të vendit në sistemin e rejtingut, besueshmëria e raportimit financiar të bizneseve, regjistrimi i pronave, sistem efikas gjyqësor sa i përket ekzekutimit të lëndëve, si dhe zhvillimi i konkurrencës.
- Sa i përket plasmanëve aktual, është fakt me rëndësi që bankat komerciale kanë filluar të investojnë në ekonominë e brendshme, duke ulur investimet e tyre jashtë Kosovës. Investimet jashtë vendit, këto banka i mbajnë vetëm sa për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të tyre.
- Banka Qendrore e Kosovës ka vepruar me kohë me rastin e falimentimit të Bankës Kreditore, duke zgjidhur këtë çështje. Rreth 11 milion euro u janë kthyer qytetarëve nga Banka Kreditore, 95% e llogarive të hapura në këtë bankë janë mbyllur, përderisa vetëm 5 % e llogarive pritet të mbyllen pasi tu kthehen paratë.
- Kosova aktualisht nuk është anëtare e sistemit ndërkombëtar të Kartonit të Gjellbër. Ajo ka marrëveshje përmes memorandumeve, vetëm me disa prej shteteve të rajonit.
- Sa i përket Trustit Pensional të Kosovës, BQK i ka rekomanduar këtij autoriteti që të punojë me afër me publikun duke e informuar me aktivitetet dhe politikat e investimeve. 55% e mjeteve të TPK-së janë të investuara në bursa. Meqë, për momentin, ka një trend të rënies së bursave në tregun ndërkombëtar, do të ishte gabim të kërkohej nga TPK që ti tërheqë aksionet dhe ti kthejë ato në Kosovë. Prandaj, BQK sugjeron që duhet të pritet stabiliteti i tregut të aksioneve. Sa i përket investimeve në Kosovë, TPK mund të investojë vetëm 5% të mjeteve në institucionet financiare në Kosovë, dhe atë vetëm në depozita, meqë nuk ekziston një bazë tjetër në këtë periudhë, në të cilën do të mund të investohet në Kosovë.
- Mbikëqyrja e institucioneve mikrofinanciare nga ana e BQK është mjaft strikte. Ato inspektohen në mënyrë strikte një herë në vit nga inspektorati i BQK. Aktiviteti i institucioneve mikrofinanciare është zhvilluar aq shumë, sa që për zhvillimin e më tutjeshëm të tyre duhet të ketë një reformim. Një reformë e tillë do të bëhej duke u transferuar këto institucione nga organizata jo qeveritare në organizata biznesore dhe në këtë mënyrë do të kenë mundësi që të marrin depozita nga BQK për zhvillim të më tutjeshëm.

Pas shkëmbimit të komenteve dhe qëndrimeve lidhur me Raportin e Autoritet Qendror Bankar të Kosovës për vitin 2007, kryetari ftoi anëtarët që të deklarohen lidhur me raport.

Të gjithë anëtarët e komisionit ishin njëzëri që Komisioni ti drejtohet Kryesisë së Kuvendit me një informatë lidhur me Raportin e Autoritet Qendror Bankar të Kosovës si në vijim:

I n f o r m a t ë

Pas shqyrtimit të raportit të Autoritetit Qendror të Bankës së Kosovës për vitin 2007, Komisioni për Buxhet dhe Financa vlerëson se ky u përgjigjet standardeve të raportimit gjithëpërfshirës financiar për situatën në Sektorin Financiar të Kosovës.

Komisioni njofton Kryesinë e Kuvendit se shqyrtimi i raportit të institucionit qendror të Autoritetit Bankar të Kosovës, në legjislaturën e mëparshme, respektivisht deri më 15 qershor

2008 ishte kompetencë e PSSS-së dhe se ky raport i AQBK-së tashmë është miratuar nga PSSP-ja.

Prandaj, Komisioni mendon që nuk ka nevojë të rimiratohet edhe një herë në Kuvend. I mbetet Kryesisë së Kuvendit që të vendos se a do të jetë temë e trajtimit dhe e debatit në seancë plenare.

Në vazhdim, kryetari hapi për diskutim pikën e tretë të trendit të ditës

3. Shqyrtimi i Projektligjit L-090/1 për partneritet publiko-privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre

Duke pasur parasysh faktin se për këtë projektligj, Komisioni për Buxhet dhe Financa është komision përgjegjës dhe raportues, Kryetari propozoi për anëtarët e komisionit që të formojnë një grup punues i cili do të shqyrtonte në detaje projektligjin dhe do të paraqiste raportin me amendamente pranë komisionit, të cilin më pas komisioni do ta shqyrtonte, miratonte dhe do t'ia paraqiste Kuvendit për shqyrtim.

Kryetari njoftoi anëtarët se komisionit i është ofruar mbështetje profesionale nga USAID, duke angazhuar një ekspert ndërkombëtarë që do të punojë shumë ngushtë me grupin punues dhe komisionin. Ai vlerësoi se grupi punues duhet të ketë parasysh disa çështje me rëndësi gjatë shqyrtimit të këtij projektligji dhe atë:

- Përcaktimi i saktë i lëndës së projektligjit, do të thotë të përcaktohet që lëndë e këtij projektligji janë koncesionet dhe kjo të rregullohet në mënyrë të qartë.
- Roli i Kuvendit të Kosovës, si institucioni më i lartë shtetëror, në procedurat e dhënies së koncesioneve. Në çfarë raste të dhënies së koncesioneve duhet të jetë i përfshirë Kuvendi i Kosovës dhe në çfarë shkalle të përfshirjes.
- Përcaktimi i qartë i afateve të dhënies së koncesioneve.

Më pas, kryetari propozoi dhe anëtarët e komisionit miratuan grupin punues për shqyrtimin e projektligjit dhe përgatitjes së raportit me amendamente për komisionin, të përbërë prej:

1. Gani Koci, udhëheqës i grupit
2. Kosara Nikolic, anëtare
3. Xhevdet Neziraj, anëtar dhe

Në vazhdim, kryetari hapi për diskutim pikën e katërt të rendit të ditës

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat

Për shkak të mungesës së përkohshme të kryetarit të komisionit, këtë pikë të rendit të ditës e udhëheqë z. **Haki Shatri**, nënkryetar i parë i komisionit.

z. Shatri ftoi anëtarët e grupit punues, përgjegjës për shqyrtimin dhe hartimin e amendamenteve lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, për të informuar komisionin lidhur me punën e bërë deri më tani.

Znj. Safete Hadergjonaj, në emër të grupit punues, në mungesë të z. Armend Zemaj, udhëheqës i grupit, njoftoi anëtarët e komisionit se grupi punues së shpejti do të takohet për të shqyrtuar edhe propozimet e reja të ofruara nga USAID dhe shpreson se në mbledhjen e ardhshme të

komisionit, grupi punues do të ketë të gatshëm dhe do ta paraqesë për komisionin raportin me amendamente.

Ajo përkujtoi anëtarët e komisionit, se lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, pas dëgjimit publik që komisioni ka mbajtur lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji, të njëjtit i janë ofruar komente dhe propozime me shkrim edhe nga grupe tjera të interesuara, si nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, pastaj nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtar. Këto komente dhe propozime janë marrë parasysh nga grupi punues, i cili gjithashtu ka bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e Administratës Tatimore të Kosovës.

z. Sakip Imeri, përfaqësues i Administratës Tatimore të Kosovës, njoftoi anëtarët e komisionit se ATK ka dorëzuar te grupi punues i komisionit propozimet e reja të cilat kanë për qëllim harmonizimin e Ligjit me situatën e Kosovës pas shpalljes së Pavarësisë.

z. Haki Shatri vlerësoi të rëndësishme punën e grupit punues dhe shprehu gatishmërinë e komisionit që në mbledhjen e ardhshme të shqyrtojë raportin final, i cili pritet të dorëzohet nga grupi punues.

Në vazhdim, z. Shatri hapi për shqyrtim pikën e pestë të rendit të ditës

5. Shqyrtimi i Projektligjit për noterinë me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, me amendamente.

Pasi që nuk kishte anëtarë të paraqitur për diskutim, kryesuesi konstatoi se komisioni përkrahë Projektligjin për noterinë me raportin e komisionit funksional dhe ftoi anëtarët të deklarohen përmes votimin lidhur me projektligjin me amendamente.

Me votimin e bërë, të gjithë të pranishmit votuan PËR dhe Komisioni njëzëri nxori këto:

R e k o m a n d i m e

- I.** Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për noterinë dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II.** Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar Raportin me amendamentet e Komisionit Funksional – Komisionit për Legjislacion dhe Gjqësi, dhe ka konstatuar se amendamentet e propozuar nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit që të miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

Më pas, z. Shatri hapi për shqyrtim pikën e gjashtë të rendit të ditës

6. Shqyrtimi i Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet tjera me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente

Kryesuesi ftoi anëtarët e komisionit të paraqesin qëndrimet e veta lidhur me këtë projektligj.

Të gjithë anëtarët e komisionit ishin të një mendimi se ky projektligj, gjatë procedurës së shqyrtimit, ka pësuar ndryshime me anë të amendamenteve të propozuara nga ana e komisioni

funksional, të cilat për nga numri janë më shumë se sa nene të vetë projektligjit, e gjithashtu ndryshimet kanë të bëjnë me strukturën dhe pjesën përmbajtjesore të projektligjit. Prandaj, me ndryshimet e propozuara përmes amendamenteve, ndryshohet edhe kostoja financiare e projektligjit, dhe deklarata financiare nr. 87 e datës 31.08.2006 e bashkangjitur projektligjit, më nuk i përgjigjet vlerësimit financiar real të projektligjit me amendamente.

Anëtarët e komisionit u pajtuan që ti drejtohen Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për një rivlerësim të projektligjit me amendamente, si në vijim:

Kërkohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, që në kohë sa më të shkurtë ti përcjellë komisionit për Buxhet dhe Financa Vlerësimin shtesë për ndikimet buxhetore të Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet tjera dhe amendamenteve të komisionit funksional – Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, që në deklaratën financiare të bashkangjitur më 31.08.2006, nr. 87 nuk janë paraqitur, por të cilat do të garantojnë zbatimin e ligjit në kuptim të përkrahjes financiare të kësaj veprimtarie.

Në vazhdim, kryetari i Komisionit Gani Koci hapi për diskutim pikën e shtatë të rendit të ditës

7. Shqyrtimi i Projektligjit për Kualifikimet Kombëtare me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente

Pasi që nuk kishte anëtarë të paraqitur për diskutim, kryetari konstatoi se komisioni përkrahë Projektligjin për Kualifikimet Kombëtare me raportin e komisionit funksional dhe ftoi anëtarët të deklarohen përmes votimit lidhur me projektligjin me amendamente.

Me votimin e bërë, të gjithë të pranishmit votuan PËR dhe Komisioni njëzëri nxori këto:

R e k o m a n d i m e

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Kualifikimet Kombëtare dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar Raportin me amendamente të Komisionit Funksional – Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, dhe ka konstatuar se amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit që të miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

Në vazhdim, kryetari hapi për diskutim pikën e tetë të rendit të ditës

8. Shqyrtimi i Projektligjit të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

Pasi që nuk kishte anëtarë të paraqitur për diskutim, kryetari konstatoi se komisioni përkrahë Projektligjin për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve me raportin e komisionit funksional dhe ftoi anëtarët të deklarohen përmes votimit lidhur me projektligjin me amendamente.

Me votimin e bërë, të gjithë të pranishmit votuan PËR dhe Komisioni njëzëri nxori këto:

R e k o m a n d i m e

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për produktet për mbrojtjen e bimëve dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional – Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, dhe ka konstatuar se amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit që të miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

Më pas, kryetari hapi për diskutim pikën e nëntë të rendit të ditës

9. Shqyrtimi i Projektligjit për Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

Pasi që nuk kishte anëtarë të paraqitur për diskutim, kryetari konstatoi se komisioni përkrahë Projektligjin për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve me raportin e komisionit funksional dhe ftoi anëtarët të deklarohen përmes votimin lidhur me projektligjin me amendamente.

Me votimin e bërë, të gjithë të pranishmit votuan PËR dhe Komisioni njëzëri nxori këto:

R e k o m a n d i m e

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për organizmat e modifikuar gjenetikisht dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional – Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, dhe ka konstatuar se amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit që të miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

Në vazhdim, kryetari hapi për diskutim pikën e dhjetë të rendit të ditës

10. Shqyrtimi i Kërkesës nr. 3192 e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave

Kërkesa nr. 3192 e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave, përmban emrat e personave në vijim:

- Skender Kolgeci, kryesues
- Miftar Shala, anëtar
- Ramadan Sejdiu, anëtar

- Ekrem Kastrati, anëtar
- Osman Sadikaj, anëtar
- Luljeta Barali, anëtare, dhe
- Hajrush Beqiri, anëtar.

Kryetari vlerësoi se dosjet e të dhënave personale të anëtarëve të propozuar nga ana e Qeverisë për anëtarë të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave, nuk janë të plota dhe disa prej tyre nuk përmbajnë të dhënat elementare për përgatitje arsimore dhe profesionale. Prandaj, kryetari i komisionit konsideroi se këto dosje do duhej të plotësoheshin me të dhënat shtesë dhe me rastin e shqyrtimit në Kuvend, të jenë të kompletuara.

Kryetari ftoi anëtarët tjerë të paraqesin qëndrimin e tyre lidhur me dosjet e anëtarëve të propozuar nga Qeveria.

z. Haki Shatri theksoi se sipas ligjit në fuqi, disa prej anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave duhet të janë përfaqësues të bizneseve. Në këtë drejtim, ata anëtarë nuk duhet të kenë ndonjë problem me ATK-në në lidhje me bizneset e tyre, dhe sipas z. Shatri ata anëtarë të cilët janë përfaqësues të biznese duhet të paraqesin një dokument dëshmi nga ATK se nuk janë në kurrfarë borxhi ndaj ATK-së dhe se asnjë procedurë nga ATK nuk është iniciuar ndaj tyre. Z. Shatri propozoi që anëtarët përfaqësues të bizneseve, të cilët janë propozuar për anëtarët të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave, të kompletojnë dosjet e tyre edhe me dëshminë e tillë nga ATK, dhe gjatë shqyrtimit në Kuvend të jenë të plotësuar dosjet e tyre.

Propozimi i z. Shatri u përkrah edhe nga anëtarët e tjerë të Komisionit.

Znj. Besa Gaxherri, vlerësoi se edhe pse për të nuk janë të njohur asnjë nga anëtarët e propozuar, ajo mendon se anëtarët e propozuar vijnë nga partitë në pushtet. Ajo kishte vërejtje lidhur me dosjet e anëtarëve të propozuar, pasi që njëri prej tyre kishte përcjellë dosjen e tij në gjuhën angleze, z. Ramadan Sejdiu, kurse disa të tjerë dosjet nuk i kishin plotësuar në formatin e duhur dhe jo me të dhëna komplete.

Pasi që edhe anëtarët tjerë ishin të një mendimi sa i përket vërejtjeve lidhur me dosjet e anëtarëve të propozuar për anëtarë të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave, kryetari ftoi anëtarët të deklarohen lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Me votimin e bërë, të gjithë të pranishmit votuan PËR dhe Komisioni njëzëri nxori këto:

R e k o m a n d i m e

1. Miratohet Propozim-vendimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të pavarur për shqyrtimin e ankesave.
2. Rekomandohet që Kuvendi me kërkesë t'i drejtohet Qeverisë dhe të kërkojë:
 - a) Biografinë komplete të anëtarëve të propozuar me CV dhe ,dhe dokumentet e përgatitjes së tyre profesionale dhe arsimore;
 - b) Dëshmi- dokumentin tatimor nga Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës (ATRK), për përmbushjen e obligimeve tatimore të anëtarëve të propozuar, me qëllim të sigurimit të përshtatshmërisë për ushtrimin e funksionit të anëtarëve të tyre.

Më pas nën pikën **5. Të ndryshme** kryetari njoftoi anëtarët e komisionit lidhur me disa shkresa, përmes të cilave i ishte drejtuar Qeverisë në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Këto shkresa kishin të bëjnë me:

- Kërkesën e dt. 9 shtator 2008 drejtuar Sekretarit të Përhershëm të Qeverisë lidhur me kompletimin e dokumentacionit për shqyrtimin dhe miratimin e Vendimit nr. 13/30 dt. 19.08.2008 të Qeverisë së Kosovës. Ky vendim kishte të bënte me ndarjen e mjeteve financiare nga Qeveria për Ministrinë e Forcës së Sigurisë, në shumë prej 1 milion euro.

- Kërkesën e dt. 10 shtator 2008 drejtuar Ministrisë për Ekonomi dhe Financa lidhur me dorëzimin e pasqyrave të pagave për anëtarët e Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik

- Këshillë juridike lidhur me Kërkesën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për përcaktimin e kompensimit plotësues për anëtarët e Këshillit dhe personelin e sekretariatit të Këshillit

Meqë nuk kishte çështje tjera të parashtruara për diskutim nën këtë pikë të rendit të ditës, nga anëtarët tjerë të komisionit, kryetari konstatoi përfundimin e mbledhjes.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Procesverbalin e përgatiti

Shërbimi i komisioneve

Kryetari i Komisionit

Gani Koci
